



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

NJOFTIM PËR NDRYSHIMET NË RAPORTIMIN E INVESTIMEVE NË /NGA JASHT VENDIT

Të nderuar raportues,

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, në datë 13.12.2017 miratoi ndryshime në rregullativën nënligjore në fushën e raportimit për gjendjen dhe ndryshimet kapitalit dhe të borxhit ndërkompani të subjekteve të lidhura kapitale në bazë të investimeve në / nga jasht vendit.

Qëllimi kryesor i ndryshimeve të fundit është lehtësimi i raportimive dhe mbledhjes të një pjese të të dhënave, për të cilat na keni informuar deri tani, por janë nga burime të tjera. Në atë drejtim, janë bërë ndryshimet e mëposhtme:

- Tek raportimet për investimet kapitale, **është shtuar metoda e mostrës** në përzgjedhjen e raportuesve, kundrejt detyrimit të deritanishëm për raportimin që vllente për të gjithë ndërmarrjet me investime kapitale të huaja. Tash e tutje, detyrim për të dorëzuar **pyetësin vjetor (formularin VS-22)** do të kenë vetëm ndërmarrjet e përzgjedhura në mostrën e raportuesve, për të cilën në kohën e duhur ata do të marrin një njoftim me shkrim nga Banka Popullore;

- Gjithashtu, për ndërmarrjet në të cilat bëhen investime me formë të organizuar "shoqëritë aksionare" të përzgjedhura në mostër, hiqet detyrimi për raportim në formularin VS-22 për **investime nga jorezidentë - investitorë portofoli** (me pjesëmarrje nën 10% në kapitalin e shoqërisë); dhe

- Gjithashtu, anulohet detyrimi i investitorëve vendas për dorëzimin e formularit vjetor VS-11 për investimet e tyre jashtë vendit në kompani me formën të organizuar "shoqëri aksionare" me pjesëmarrje nën 10% në aksionet e emetuara, si dhe për investime në aksione dhe aksione të fondeve të investimeve.

Ndryshimet e fundit të akteve nënligjore janë të disponueshme në faqen e internetit të Bankës Popullore, në adresat e mëposhtme të internetit:

[„Упатство за изменување и дополнување на Упатството за начинот на известување за состојбата и промените на капиталот и на меѓукомпанискиот долг на капитално поврзаните субјекти врз основа на вложувања во странство“](#) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr.185/17 nga 18.12.2017); dhe



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

„Упатство за дополнување на Упатството за начинот на известување за состојбата и промените на капиталот и на меѓукомпанискиот долг на капитално поврзаните субјекти врз основа на вложувања од странство“ („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr.185/17 nga 18.12.2017)